



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.37/2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike të Kosovës (PDK) me seli në Skenderaj për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 11.01.2011, mori këtë:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

#### ARSYETIMI

Më datën 09.01.2011, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se ma datë 09.01.2011 në fshatin Rezall komuna e Skenderajt në QV 2116 shkolla fillore “Malush Ahmeti” udhëheqësi i vëzhguesve të Vetëvendosjes Durim Jasharaj ka raportuar se njëri prej vëzhguesve të LVV, Flamur Arifaj e ka vërejtur që një person ka tentuar për të votuar dy herë në një klasë dhe një herë në klasën tjetër dhe ia ka arritur qëllimit. Durim Jasharaj udhëheqësi i vëzhguesve ka raportuar se ka shumë raste që tentojnë të votojnë më shumë se dy herë të cilët as nuk i spërkasin gishtërinjtë. Sipas parashtruesit të ankesës vëzhguesit e tyre kërcënohen vazhdimisht nga vëzhguesit e PDK-ës dhe persona të tjerë të cilët janë pa bexha dhe nuk dihet se ne çfarë cilësie janë.

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

*3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka përmendur se cilët janë ata persona që kanë kërcënuar si dhe nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale si dëshmi, që do të bënte të besueshme ekzistimin e shkeljes së pretenduar. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 37/2011 më datën 11.01.2011

